

KRIKË E BIBLIOGRAFI

Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe, botim i Sektorit të leksikologjisë e të leksikografisë të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, Tiranë 1972, vol. II, 400 f.

Me çlirimin e vendit dhe me vendosjen e pushtetit popullor zhvillimi i shkencës gjuhësore mori përpjestime të papara ndonjëherë, si përsa i përket bazës shkencore, metodologjisë e metodës së punës, ashtu edhe në drejtim të karakterit të punës shkencore. Në kuadrin e këtij zhvillimi të gjithanshëm të gjuhësisë shqiptare, një vend të rëndësishëm zënë studimet në fushën e leksikologjisë e të leksikografisë, degë në të cilat dalin në dritë veçoritë kombëtare të shqipes në fushën e leksikut, të frazeologjisë e të formimit të fjalëve. Zgjerimi i vazhdueshëm i kësaj pune, larmia e studimeve dhe e artikujve të botuar në organe të ndryshme, kërkesat gjithnjë në rritje për njohjen dhe shfrytëzimin e kësaj literature, shtruan nevojën e botimit të një përmbledhjeje në fushën e leksikologjisë e të leksikografisë. Botimi i dy vëllimeve «Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» përbën një hap shumë pozitiv në njohjen dhe në përhapjen sa më gjerë të mendimit shkencor, duke nxitur njëkohësisht punën për kërkime të mëtejshme. Botimi i këtyre vëllimeve ka rëndësi jo vetëm për gjuhëtarët dhe njerëzit që merren me studime e punime në këto fusha, por edhe për masën e gjerë, sidomos për mësuesit e gjuhës shqipe dhe për punonjësit e shtypit. Rëndësi të veçantë ka botimi i këtyre dy vëllimeve sidomos për studentët e profilit të gjuhës shqipe në shkollat e larta, sepse u jep në dorë një material të përmbledhur dhe bazë për studimin e këtyre fushave.

Në materialet e botuara në vëllimin II të «Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» pasqyrohen disa nga rezultatet kryesore të arritura në fushën e leksikografisë, të terminologjisë, të marrëdhënieve historike leksiko-frazeologjike të shqipes me gjuhët e tjera etj. Kështu me rëndësi janë: monografia e prof. A. Kostallarit «Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe» dhe punimi i tij «Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme»; studimi i J. Thomajt e Xh. Lloshit «Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit»; punimi i prof. E. Çabejt «Gjendja e sotme dhe detyrat e etimologjisë së gjuhës shqipe»; studimi i L. Dodbibës «Leksiku i sotëm detar i shqipes dhe elementet e tij të pahuazuara»; studimet e J. Thomajt «Mbi disa togje të qëndrueshme të shqipes në shek. XVI në krahasim me shqipen e sotme» dhe «Zhvillimi i teorisë dhe i praktikës leksikografike shqiptare pas çlirimit»; punimi i F. Lekës e S. Morckës «Zhvillimi dhe pasurimi i

terminologjisë pas çlirimit» etj. Autorët e studimeve të botuara nuk kufizohen vetëm me trajtimin dhe zbërthimin konkret të temave të ndryshme, por shtrojnë edhe një varg detyrash për të ardhmen, hapin perspektivën e studimeve të mëtejshme në këto fusha.

Një vend të rëndësishëm në vëllimin e dytë zënë studimet rreth «Fjalorit të gjuhës shqipe», (1954) si edhe mbi problemet e detyrat që i dalin leksikografisë shqiptare në rrugën e hartimit të një fjalori të ri të gjuhës shqipe.

Në kuadrin e këtyre studimeve, rëndësi të veçantë ka monografia e prof. A. Kostallarit «Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe».

Në këtë punim autori ka gjithnjë parasysh se hartimi i «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe» shtron, para së gjithash, detyrën e zgjidhjes teorike të problemeve kryesore e të përgjithshme të çdo fjalori shpjegues të shqipes së sotme e në mënyrë të veçantë të fjalorëve shpjegues normativë. Në një vështrim të drejtpërdrejtë, këto probleme kanë të bëjnë me gjendjen dhe prirjet e zhvillimit të leksikut të shqipes së sotme në procesin e kristalizimit të normës letrare kombëtare, me diferencimin e shtresëzimit stilistikor që vihet re gjatë këtij procesi, si edhe me bashkëmarrëdhëniet midis normës leksikore e normës gramatikore, drejtshkrimore e drejtshqiptimore të sotme. Por, në një vështrim më të gjerë, ato lidhen me vetë kuptimin e shpjegimit historiko-teorik të evolucionit të ndërlikuar që ka bërë gjuha shqipe për t'u ngritur nga një gjuhë kombësie në gjuhë kombi e për t'u formuar si gjuhë letrare kombëtare.

Siç nënvizon vetë autori, koncepti që përshkon tejndanë parimet themelore të «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe» është ky: «*Sot ne kemi një gjuhë të vetme letrare kombëtare shqipe*, e cila si e tillë, është formuar historikisht gjatë këtij shekulli të fundit dhe po kristalizohej përfundimisht si një koine letrare sui generis. Pikërisht për këtë arsye hartimi i një fjalori shpjegues me karakter normativ sot është jo vetëm i domosdoshëm, por edhe plotësisht i mundshëm».

Studimi ndahet në dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë (A) «Gjuha jonë letrare dhe detyrat e tiparet e përgjithshme të «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe», parashtrohen shkurt detyrat dhe tiparet më të përgjithshme të «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe», të para në dritën e rolit që ai duhet të luajë për thellimin e zgjerimin e njohjes së thesarit leksikor të popullit tonë dhe për ngulitjen e normës letrare kombëtare. Këtu autori nënvizon, ndërmjet të tjerash, se shoqërisë sonë, kombit shqiptar socialist i duhet një fjalor shpjegues që të përfshijë sa më gjerë leksikun e gjuhës së sotme shqipe që ka një përdorim të përgjithshëm ose që mund të hyjë në një përdorim të tillë në një të ardhme të afërt, si edhe frazeologjinë gjuhësore e togjet më tipike, që tregojnë jetën e gjallë të fjalëve në gjuhën e shkruar e të folur. Në këtë mënyrë ky fjalor do t'u shërbejë masave sa më të gjera të lexuesve.

Qëllimet kryesore, që i ve autori «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe», për të plotësuar detyrat që i shtron shoqëria jonë, janë dy: a) të jetë një fjalor shpjegues normativ; b) të jetë njëkohësisht një fjalor informues.

Qëllimi i parë realizohet duke dhënë normat e përdorimit të fjalëve që hynë në leksikun e gjuhës së sotme letrare shqipe. Ndërsa detyra kryesore informuese e «Fjalorit» qëndron në faktin që të bëjë të njohur në botën letrare e në masa sa më të gjera atë pasuri të madhe leksikore-frazeologjike të gjuhës së folur të popullit tonë, që deri më sot nuk është pasqyruar nëpër fjalorë e botime, por që është e parapërcaktuar historikisht të bëhet pjesë e pandarë e fondit leksikor të gjuhës sonë letrare kombëtare». Kjo do të arrihet duke e vlerësuar pasurinë leksikore-frazeologjike të gjuhës së folur të popullit në dritën e strukturës leksikore dhe të tendencave të zhvillimit të sotëm të gjuhës letrare dhe duke e pasqyruar atë në mënyrë sa më të plotë e sistematike. Pikërisht kjo është ajo zgjidhje e re, ai konceptim origjinal i ri i rolit informues të «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe» që krijon mundësinë e hartimit të një fjalori të tillë.

Në pjesën e dytë (B) «Parimet e kriteret themelore për zgjidhjen e problemeve të veçanta të «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe», përfshihen parimet e kriteret themelore, tek të cilat do të mbështetet vetë hartimi i fjalorit për të zgjidhur problemet më të rëndësishme që i dalin në fusha e drejtime të caktuara. Këto parime e kriteret që rrjedhin pikërisht nga vetë qëllimet e detyrat kryesore të «Fjalorit» e që çojnë në plotësimin e tyre konkret, kanë të bëjnë, mbi të gjitha, me probleme të tilla si: I) Zgjedhja e fjalëve (përbërja e fjalësit); II) Frazeologjia dhe ilustrimet në fjalor; III) Struktura e fjalorit dhe struktura e artikullit për çdo fjalë; IV) Homonimet; V) Zbërthimi e shpjegimi i kuptimeve të fjalëve; VI) Pasqyrimi i veçorive stilistikore të fjalëve; VII) Karakteristika gramatikore e fjalëve; VIII) Njohuritë etimologjike në fjalor; IX) Çështje të drejtshkrimit; X) Problemi i theksit. Ndër këto probleme disa trajtohen më gjerë, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre të veçantë dhe vështirësitë më të mëdha që nxjerr zgjidhja e tyre. Të tilla janë sidomos përbërja e fjalësit dhe e frazeologjisë, zbërthimi e shpjegimi i kuptimeve, përcaktimi i veçorive stilistikore dhe karakteristika gramatikore e fjalëve.

Në fund shtrohet si detyrë kryesore dhe e rëndësishme, për të gjithë studjuesit, që të studjohen më tej dhe më me imtësi problemet e trajtuara në këtë punim, sepse kjo është rruga për ta pakësuar ca nga ca largësinë që ndan sot tek ne praktikën leksikografike nga teoria leksikografike dhe për t'i vënë punimet tona në këtë fushë mbi një bazë teorike më të shëndoshë e të qëndrueshme.

Ky punim i prof. A. Kostallarit ka një rëndësi të madhe për leksikografinë shqiptare, sepse hedh bazat teorike mbi të cilat po mbështetet puna për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe» dhe të fjalorëve të tjerë të tipeve të ndryshme, që do të hartohen në të ardhmen, trajton dhe u jep rrugë zgjidhjeje një vargu problemesh, që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me teorinë dhe praktikën leksikografike, duke u bërë, në këtë mënyrë, një program pune për të gjithë ata që do të merren me hartimin, studimin, analizën e fjalorëve të ndryshëm të gjuhës shqipe. Me plot të drejtë këtë studim të prof. A. Kostallarit mund ta quajmë si programatik për leksikografinë shqiptare.

Këtë studim e pasojnë, në vëllimin e dytë, një sërë punimesh të tjera që kanë të bëjnë me teorinë e praktikën leksikografike. Këto punime, siç janë p.sh. «Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme» i prof. A. Xhuvanit, «Mbi mënyrën e pasqyrit të sistemit të kuptimeve dhe të përdorimeve të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe» i J. Thomajt, «Mbi fondin e fjalëve dhe kuptimet e tyre në «Fjalorin e gjuhës shqipe» i F. E. Ndocajt etj., marrin dhe analizojnë në vështrim kritik «Fjalorin e gjuhës shqipe», të botuar në vitin 1954 nga Instituti i Shkencave. Duke i bërë një analizë kritike materialit leksikor të përmbledhur në këtë fjalor dhe mënyrës së pasqyrit të tij, autorët ngrenë lart punën që është bërë për hartimin e këtij fjalori, nënvizojnë rëndësinë e pamohueshme që ka botimi i këtij fjalori për mbarë popullin tonë dhe në mënyrë të veçantë për gjuhësinë shqiptare. Krahas anëve pozitive, në këto punime nënvizohen dhe një varg të metash e dobësish, që vihen re në «Fjalor», të cilat në të ardhmen duhet të ndreqen pa tjetër. Gjithashtu, shtrohen edhe një sërë detyrash, realizimi i të cilave është i domosdoshëm në punën për hartimin e një fjalori të ri të gjuhës shqipe. Kështu, prof. A. Kostallari, në punimin e tij «Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme», ndërmjet të tjerash nënvizon se: «për të hartuar një fjalor me karakter normativ është e nevojshme: 1) të zgjidhen drejt fjalët që do të shpjegohen në fjalor; 2) të ndahen, të shpjegohen dhe të përkufizohen drejt kuptimet primare dhe sekondare të fjalëve, duke pasur parasysh që shpjegimi t'i shërbejë lexuesit për të kuptuar drejt përdorimin real të fjalëve; 3) të përcaktohen drejt kufijtë dhe sfera e përdorimit të fjalëve ose të kuptimeve të tyre të ndryshme, duke dhënë karakteristikat e nevojshme stilistike; 4) të jepen shpjegime gramatikore në bazë të normës gramatikore të sotme; 5) të tregohet në çfarë lidhjesh dhe kombinimesh përdoret fjala në kuptimet e saj të veçanta, duke dhënë shprehje, citate e shembuj bindës, të nxjerrë nga burime të sigurta e me autoritet, për të mos lejuar në asnjë mënyrë ndërtime e gërshetime që nuk i përgjigjen realitetit objektiv të gjuhës; 6) të jepet drejt ortografia e çdo fjale ose e variantit të saj letrar; 7) të jepet mënyra letrare e shqiptimit dhe të tregohet posaçërisht vendi i theksit». Autori i kushton gjithashtu rëndësi të veçantë problemit të fjalëve të huaja, sidomos turqizmave, luftës kundër tyre, mënyrës dhe kufizimit të pasqyrit të tyre në një fjalor të gjuhës së sotme shqipe. Në punim zë një vend të veçantë problemi i zbulimit dhe i shpjegimit të drejtë të kuptimeve të fjalëve dhe i dhënies së karakteristikave gramatikore e stilistikore të fjalëve.

Me probleme të tilla merret në punimin e tij edhe prof. A. Xhuvani. Autori këtë punim e ka shkruar në kuadrin e diskutimit të gjerë që u hap për «Fjalorin e gjuhës shqipe» të 1954-ës. Ai shpreh mendimin e tij lidhur, jo vetëm me botimin e këtij fjalori, por edhe me studimin e prof. A. Kostallarit «Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme».

Në punimet e tyre J. Thomaj, M. Samara, P. Geci dhe F. E. Ndocaj trajtojnë probleme të veçanta që lindin nga botimi i «Fjalorit të

gjuhës shqipe» të 1954-ës dhe zgjidhin një sërë detyrash të karakterit teorik e praktik për një fjalor të gjuhës shqipe.

Në studimin «Mbi mënyrën e pasqyrimit të sistemit të kuptimeve dhe të përdorimeve të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe» J. Thomaj trajton dhe i jep rrugë zgjidhjeje problemeve të tilla si: struktura kuptimore e fjalëve, çështja e kuptimeve jo të lira, frazeologjikisht të lidhura të fjalëve, çështja e përdorimeve të figurshme të fjalëve, kalimi i këtyre në elemente gjuhësore, si edhe çështja e pasqyrimit në fjalor të kuptimeve leksikore, frazeologjike dhe të përdorimeve të fjalëve.

Ndërsa M. Samara, në punimin e tij «Mbi karakterin antonimik të kuptimeve të fjalëve në gjuhën shqipe dhe pasqyrimin e tyre në fjalorin shpjegues», bën analizën e këtij problemi duke u mbështetur në materialin faktik të gjuhës së folur dhe të shkruar, si edhe në «Fjalorin e gjuhës shqipe» (1954). Duke u nisur nga përkufizimi që i është bërë deri në atë kohë antonimeve në gramatika e tekste të ndryshme shkollore, si dhe në fjalorë të ndryshëm të shqipes, të botuar deri në atë kohë, autori shtron një varg pyetjesh si: Ç'është kuptimi i kundërt tek antonimet? A është mohimi tregues i karakteristikës antonimike të fjalëve? Si paraqitet në gjuhën shqipe antonimia e bazuar vetëm në mohim? Mohimi i kuptimit të njëres prej gjymtyrëve të çiftit antonimik a e zbulon kuptimin e gjymtyrës tjetër? Në përpjekjet për t'i dhënë një zgjidhje sa më të saktë, autori analizon antonime të tipeve të ndryshme. Kështu, krahas antonimeve të tipit *hap-mbyll*, ku kundërvënia del e qartë, e plotë, e fortë, autori i analizon edhe çiftet antonimike të tipit *i mirë-i keq*, në të cilët kuptimi i njëres fjalë nuk mund të shpjegohet thjesht me anë të mohimit të fjalës tjetër. Një vend të veçantë në këtë punim autori i ka kushtuar fjalëve antonime me parashtesa, ku rolin kryesor në lindjen e marrëdhënieve antonimike ndërmjet kuptimeve e luan parashtesa. Ai merr në analizë një varg çiftesh antonimike të formuara me parashtesa të tilla mohuese si *pa-*, *mos-*, *jo-* etj.

Ky punim i M. Samarës ka rëndësi të veçantë sidomos për praktikën e punës në hartimin e fjalorëve, sepse ai është munduar të japë dhe mënyrën e pasqyrimit konkret të antonimeve në fjalor.

Ndërsa P. Geci në punimin «Pasuria e leksikut të shqipes dhe fjalori i gjuhës shqipe» dhe F. E. Ndocaj në punimin «Mbi fondin e fjalëve dhe kuptimet e tyre në «Fjalorin e gjuhës shqipe» merren me analizën konkrete të glosarit të «Fjalorit të gjuhës shqipe» (1954).

Studimet «Zhvillimi dhe pasurimi i terminologjisë pas çlirimit» i F. Lekës e S. Morckës, «Aspekte të zhvillimit të terminologjisë tekniko-shkencore» i F. Lekës, si edhe recensionet e F. Lekës, E. Lafes, Xh. Lloshit dhe M. Samarës mbi disa fjalorë të terminologjisë tekniko-shkencore të botuar pas çlirimit, tregojnë për gjerësinë e madhe që mori teoria dhe praktika terminologjike në këto vitet e fundit në vendin tonë.

Në studimin e F. Lekës dhe S. Morckës, pasi i bëhet një përshkrim i përgjithshëm zhvillimit të terminologjisë shqipe ndër shekuj, duke nisur që me Pjetër Bogdanin, jepen kriteret themelore që ndiqen për hartimin e fjalorëve terminologjike. Kritere të tilla si: të

shfrytëzohen sa më shumë e në mënyrë të gjithanshme mundësitë e mëdha që ka gjuha jonë, për të krijuar fjalë-terma nga brumi i vet; të shfrytëzohen sa më shumë e sa më mirë mënyrat dhe tipet më prodhues të fjalëformimit në gjuhën e sotme shqipe; të shqipërohen termat shkencorë jo-ndërkombëtarë, duke quajtur ndërkombëtarë ata terma që i kanë të përbashkët jo vetëm dy ose më shumë gjuhë neolatine, por që takohen edhe në gjuhë të tjera etj. kanë bërë të mundur hartimin e fjalorëve terminologjikë me baza të shëndosha shkencore.

Bashkautorët shtrojnë një varg detyrash që i dalin terminologjisë sonë për të ardhmen. Ata vënë si detyrë të rëndësishme që mbi bazën e realizimeve të deritanishme të bëhen edhe studime mbi problemet aktuale të terminologjisë sonë tekniko-shkencore. Gjithashtu krahas përpunimit të fjalorëve shqip-gjuhë të huaja të ecet edhe në drejtim të hartimit të fjalorëve terminologjikë me shpjegime për ato degë ku janë hedhur bazat e terminologjisë. Si detyrë aktuale këtu mbetet gjithnjë fusha e studimit të atyre terminologjive që lidhen me sferat e prodhimit.

Studimi i prof. E. Çabejt «Gjendja e sotme dhe detyrat e etimologjisë së gjuhës shqipe» analizon rezultatet e arritura, gjendjen e sotme dhe detyrat që dalin për të ardhmen në fushën e etimologjisë shqiptare. Autori arrin në konkluzionin se puna e kryer gjer më sot në këtë fushë, përbën vetëm një bazë të parë për një veprimtari të mëtejshme, qëllimi përfundimtar i së cilës duhet të jetë një fjalor etimologjik i ri i gjuhës shqipe.

Autori shënon se për të realizuar me sukses një detyrë të tillë të rëndësishme duhet të udhëhiqemi në radhë të parë nga kriteri që në leksikonin e shqipes të dallojmë elementet me burim të huaj nga burimi i vendit. Në këtë mënyrë, në marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera fqinjë duhet të merret parasysh jo vetëm roli marrës i saj, por edhe roli i dhënësit. Sidomos kjo e fundit është me rëndësi, sepse në elementet shqiptare që shfaqen në gjuhët fqinjë janë ruajtur trajta më të vjetra, të cilat rrjedhin nga një periudhë paraletrare e gjuhës shqipe dhe si të tilla janë në gjendje të ndihmojnë për të rindërtuar disa shkallë më të vjetra të zhvillimit historik të saj. Gjithashtu autori vëren se duhet bërë mirë dallimi në fjalët me burim vendi, i atyre fjalëve që janë të lashta e të gurrës indoevropiane, nga ato fjalë që ka krijuar vetë shqipja, për nevojat e reja e të vazhdueshme të saj.

Autori, duke u nisur nga një vështrim i përgjithshëm i leksikut të shqipes, ka arritur në konkluzionin se: «Nga leksiku i shqipes, gjithë ajo pjesë që i përket një jete të lidhur me natyrën dhe një ekonomi e një kulture më fort primitive, në pjesën më të madhe na del e pajisur me fjalë të visarit leksikor të trashëguar. Elementi i huaj përkundrazi mbizotëron në atë pjesë të fjalorit që lidhet me një jetë materiale e morale më të zhvilluar».

Me rëndësi është punimi i L. Dodbibës «Leksiku i sotëm detar i shqipes dhe elementet e tij të pahuazuara». Autori, duke shfrytëzuar atë pjesë të leksikut detar të mbledhur deri në atë kohë, i vihet ndesh mendimeve të G. Waigandit dhe N. Joklit mbi autoktoninë e shqiptarëve dhe pohon mendimin e prof. E. Çabejt mbi autoktoninë e shqip-

tarëve në viset bregdetare. Për këtë qëllim autori merr dhe analizon një varg fjalësh të leksikut detar të shqipes, si p.sh. *det, ujë, ujëra, valë, buzë* etj. dhe duke u mbështetur në etimologjinë e tyre, jep një material mjaft të pasur për etimologjinë shqiptare.

Ndërsa J. Gjinari, në punimin e tij «Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë Jugore», merret me marrëdhëniet shqiptaro-sllave në leksik dhe fjalëformim. Autori trajton këtu elementet sllavë në grupin e atyre të folmeve të dialektit jugor të shqipes që shtrihen ndërmjet lumenjve Vjosë dhe Shkumbin. Në mënyrë të veçantë autori trajton prapashtesa të tilla si *-kë, -çkë, -icë, -nik* etj. dhe arrin në përfundimin se ka shumë të ngjarë që hyrja e këtyre prapashtesave në të folmet e toskërishtes veriore të jetë favorizuar në një masë të konsiderueshme pikërisht në zonat lindore, sidomos në krahinat kufitare, ku kanë vazhduar për një kohë të gjatë marrëdhëniet e fqinjësisë.

Në studimin «Hyrja e turqizmave në shqipen dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre» A. Krajni merret me problemin e hyrjes së turqizmave në gjuhën shqipe, me densitetin e tyre, me rrugët e hyrjes së tyre në shqipen, si edhe me rrugën që duhet ndjekur sot për pastrimin e gjuhës shqipe nga turqizmat.

P. Geci në studimin «Frang Bardhi dhe «Fjalori» i tij latinisht-shqip» i bën një analizë të mirë punës së Frang Bardhit dhe «Fjalorit» të tij. Ai nënvizon rëndësinë e madhe historike që ka ky fjalor për gjuhën shqipe dhe për leksikografinë shqiptare, sepse është i pari monument në leksikografinë shqiptare.

Ndërsa Xh. Lloshi në studimin «Mbi problemin leksiko-semantik të mbiemrit tek «Istori e Skënderbeut» e N. Frashërit» trajton çështje të tilla si kuptimet leksikore, sinoniminë dhe antoniminë e mbiemrave; shqyrtimi i veçorive të togfjalëshave dhe interpretimi i mundshëm i të dhënave që dalin, mbështetur në dendurinë e përdorimit.

Në studimin «Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit» të bashkautorëve J. Thomaj e Xh. Lloshi gjejnë një punë me vlerë të madhe shkencore në lëmin e frazeologjisë. Objekti kryesor i këtij studimi janë konkordancat në lëmin e frazeologjizmave gjuhësore. Autorët vërejnë se konkordancat e shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit, po ashtu dhe ndërmjet gjuhëve të Ballkanit, në drejtim të frazeologjizmave gjuhësore, nuk janë dhe nuk duhen parë thjesht si përputhje njësisht të veçuara dhe të rastit, por si paralele tipash, llojesh, kategorish. Paralele të tilla vërehen si nga struktura e tyre formale, ashtu dhe nga ndërtimi semantik.

Autorët dallojnë disa tipa frazeologjizmesh. Tipi më i zakonshëm dhe më i pasur, në të cilin shqipja gjen analogjitë e saj në gjuhë të tjera të Ballkanit, përbëhet nga frazeologjizmat gjuhësorë, të cilët janë formuar si rezultat i shndërrimit të togfjalëshave të lirë në togfjalësha frazeologjike. Me këtë tip lidhet edhe formimi i frazeologjizmave, që e ruajnë idenë e krahasimit. Veç këtyre, shqipja gjen në gjuhë të tjera të Ballkanit paralele edhe të atyre frazeologjizmave, që ndërtohen mbi bazën e hiperbolës. Veç këtyre tipave dhe disa tipave të tjerë të analizuar në aspektin semantik, autorët i gjurmojnë analogjitë në frazeologjizmat edhe në pikëpamje të ndërtimit formal.

Kështu shqipja gjen paralele të plota ose tipologjike në gjuhë të tjera të Ballkanit në tipin foljor, emëror, mbiemëror e ndajfoljor të frazeologjizmave.

Autorët në këtë punim ngrenë dhe problemin e etimologjisë së këtyre frazeologjizmave, si një problem i rëndësishëm, por mjaft i vështirë. Ata gjithashtu shtrojnë detyrën e mbledhjes e të studimit të frazeologjizmave, sepse kjo do të nxjerrë në dritë fondin frazeologjik të gjuhëve me një jetë të gjatë në gojën e popullit dhe me vulën popullore si dhe lidhjet, bashkësinë e ndryshimet e gjuhëve në këtë fushë. Nga ana tjetër do të zgjidhen mjaft probleme praktike të hartimit të fjalorëve një ose dygjuhësh.

Në punimin e tij «Mbi disa togje të qëndrueshme të shqipes së shek. XVI në krahasim me shqipen e sotme» J. Thomaj, duke u mbështetur në «Mesharin» e Buzukut, i bën një analizë të hollësishme togjeve frazeologjike të përdorur në shqipen e shek. XVI dhe njërive njëfjalëshe që lidhen me frazeologjizma të tilla. Duke e parë materialin në plan krahasues me shqipen e sotme, autori nxjerr një sërë konkluzionesh mbi gjuhën e Buzukut, mbi frazeologjitë e përdorura prej tij dhe mbi prirjet e zhvillimit të shqipes në këtë fushë. Me të drejtë autori thekson në fund se mbi bazën e fakteve të nxjerra mund të gjykojmë edhe për shqipen e shek. XVI dhe ta përdorim këtë si një mbështetje për të kuptuar procesin e zhvillimit të mëtejshëm deri në ditët tona.

Një vend të mirë zënë në këtë vëllim një sërë recensionesh mbi disa fjalorë dygjuhësh të kohës sonë. Kështu kemi recensionet e Xh. Lloshit «Fjalorët shqip-anglisht e anglisht-shqip dhe Fjalori anglisht-shqip» i Stuart Manit» dhe «Fjalor bullgarisht-shqip», recensionin e P. Gecit «Sokol Dobroski: Fjaluer serbokroatisht-shqip», atë të bashkautorëve P. Geci, A. Krajni «Fjalor shqip-hungarisht» dhe të M. Samarës «Mendime për fjalorin frengjisht-shqip». Në këto recensione autorët, duke theksuar rëndësinë e madhe të këtyre fjalorëve dygjuhësh, nxjerrin dhe një sërë detyrash për të ardhmen në këtë fushë. Leksikografia dygjuhëshe shqipe pas çlirimit ka bërë një hap të ri cilësor. Përveç metodologjisë së re ku u mbështet, metodave të reja që përdori, parimeve e kriterëve teorike që e përshkojnë, ajo ndryshoi edhe përmbajtjen e lëndës dhe karakterin e kësaj lënde në fjalorët: fondi shqip i glosarit ka karakter të përgjithshëm, kombëtar, koncepti i normës leksikore bëhet gjithnjë e më i qartë nga fjalori në fjalor, zgjerohet leksiku abstrakt e ndriçohen trajtat letrare të kohës, rritet fondi popullor i leksikut e i frazeologjisë, përpunohen një varg çështjesh me rëndësi për teorinë e praktikën leksikografike dhe për kuptimin e normativitetit në fjalor në lidhje me gjendjen e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe, hidhen hapat e para për një vlerësim stilistik të diferencuar të materialit leksikor etj.

Në përgjithësi autorët shtrojnë si detyrë kryesore për të ardhmen hartimin e fjalorëve të tipit të mesëm dhe të një niveli më të lartë shkencor, që do t'u shërbejnë edhe më mirë jo vetëm studjuesve të ndryshëm, por edhe masave të gjera.

Në vëllimin II të «Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» përfshihet edhe studimi i J. Thomajt «Zhvi-

llimi i teorisë dhe i praktikës leksikografike shqiptare pas çlirimit». Këtu autori bën një historik të shkurtër të zhvillimit të leksikografisë shqiptare, të cilin e ndan në dy periudha të mëdha: periudha e parë fillon me fjalorin e parë të shqipes dhe vjen deri në çlirimin e Shqipërisë dhe e dyta është periudha që nga çlirimi e deri në ditët tona.

Në periudhën e parë autori nënvizon sidomos rëndësinë e madhe të «fjalorit të gjuhës shqipe» të Kristoforidhit. Autori nënvizon se: «Fjalori i K. Kristoforidhit qe një hap i madh në leksikografinë shqipe të kohës, sepse vuri gurët e parë si premisa në disa drejtime: a) ai realizoi në praktikë idenë se pasuria leksikore-frazeologjike e dialekteve dhe e të folmeve duhet vlerësuar si pasuri e përbashkët e gjuhës shqipe; b) Kristoforidhi është i pari në leksikografinë tonë që ndërmoi hartimin e një fjalori të gjuhës shqipe, pa ja ngushtuar bazën në një dialekt a të folme; c) me fjalorin e tij ai hodhi hapat e para për një fjalor shpjegues të shqipes dhe zbatoi në disa vija një shtresëzim të brendshëm të leksikut në fjalor, duke ndarë të përgjithshmen nga krahinorja, shqipen nga e huaja, fjalët e vjetra (të autorëve) nga leksiku i sotëm etj., me anë të shënimeve plotësuese; d) ai përjashtoi nga fjalori turqizmat, hapi rrugë për krahasime leksikore ndërdialektore e ndërgjuhësore dhe nxori në dritë për së pari një pasuri të madhe frazeologjie popullore.

Periudhën e dytë të leksikografisë shqipe autori e ndan në dy faza. Si kufi ndërmjet tyre ai merr botimin e «Fjalorit të gjuhës shqipe». Si realizimin më të madh të fazës së parë ai shënon hartimin e të parit fjalor shpjegues të mirëfilltë të shqipes, të tipit të vogël. Ndërsa faza e dytë, e cila vjen pas botimit të këtij fjalori, është faza më dinamike dhe më e pasur në historinë e zhvillimit të leksikut të gjuhës shqipe. Në këtë periudhë vendin kryesor e zënë pasurimi i kartotekës së leksikut të shqipes dhe hartimi i «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe». Për këtë autori shtron një sërë detyrash të rëndësishme realizimi i të cilave do ta çojë shumë më përpara leksikografinë tonë. Të tilla detyra janë pasurimi i vazhdueshëm i kartotekës, nevoja e trajtimit shkencor të shumë problemeve e çështjeve me karakter teorik e praktik, rivlerësimi i trashëgimisë etj.

Botimi i vëllimeve «Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe» përbën në vetvete një hap të rëndësishëm dhe shumë pozitiv në rrugën e botimit të studimeve në fushën e leksikologjisë e të leksikografisë. Të gjitha këto tregojnë se kjo fushë studimesh e gjuhësisë shqiptare ka hyrë në një rrugë të gjerë e plot perspektivë, se ka kaluar tashmë prej kohësh stadi i njohurive empirike dhe se ka filluar një punë e thelluar për zgjidhjen teorike të problemeve, e cila në të ardhmen do të sjellë, pa dyshim, rezultate edhe më të mëdha.

AGIM HIDI

еднѣмъ же и мадри...
 вѣрнѣе же и мадри...
 мадри...
 мадри...

мадри...
 мадри...
 мадри...
 мадри...

мадри...
 мадри...
 мадри...
 мадри...

мадри...
 мадри...
 мадри...
 мадри...